



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

PËR

MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR TRAJTIMIN, SHFRYTËZIMIN, SHITJEN, EKSPORTIN, IMPORTIN, ADMINISTRIMIN DHE TRANSPORTIN E MATERIALIT DRUSOR DHE TË PRODHIMEVE JODRUSORE PYJORE, KATEGORIZIMIN E RRUGËVE AUTOPYJORE, PËRDORIMIN DHE STANDARDET TEKNIKE TË TYRE, SI DHE KRITERET PËR SHËNIMIN DHE ETIKETIMIN E PRODHIMEVE DRUSORE DHE PËR PRERJET SHFRYTËZUESE NË SIPËRFAQET ME FILIZËRI TË ZHVILLUAR MBI LARTËSINË OPTIMALE.

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikat 1 dhe 3 të nenit 26, pika 4 e nenit 27, dhe shkronjat “ç” dhe “dh”, të pikës 1 të nenit 32, të ligjit nr.57/2020, “Për pyjet”, me propozim të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave, që lidhen me:
 - a) trajtimin dhe shfrytëzimin e materialit drusor dhe të prodhimeve jodrusore pyjore, me synim përfitim nga to dhe garantimin e mbarështimit të qëndrueshëm dhe vijimësisë së prodhimit të Fondit Pyjor Kombëtar;
 - b) shitjen, eksportin (rastet e lejuara), importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor e të prodhimeve jodrusore pyjore, bimëve mjekësore eterovajore e tanifere natyrore (BMET);
 - c) kategorizimin e rrugëve pyjore, përdorimin dhe standardet teknike, rregullat e ndërtimit, riparimit dhe mirëmbajtjes së tyre.

- ç) përcaktimin e kritereve për shënimin me bojë të paheqshme dhe vendosjen e etiketave në prodhimet drusore.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllimin e këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Rregullat e trajtimit dhe shfrytëzimit” janë, tërësia e ndërhyrjeve që aplikohen mbi një grumbull pyjor, mbështetur në parimin e vijimësisë dhe të mbarështrimit të qëndrueshëm, dhe në respekt të plotë të rregullave dhe procedurave teknike të silvikulturës.
- b) “Leje shfrytëzimi” është dokumenti i lëshuar nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki pas nënshkrimit të kontratës së shfrytëzimit, që përmban të dhëna për ekonominë pyjore, ngastrën/nënngastrën, llojin e materialit drusor/jodrusor pyjor/BMTE, sasinë miratuar, afatin e prerjes/grumbullimit, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e ngastrave/nënngastrave të dhëna për shfrytëzim.
- c) “Transport i brendshëm”, lëvizja e materialit drusor nga ngastra në sheshin e depozitimit.
- ç) “Shesh depozitimi”, ka kuptimin e një vendi të caktuar brenda ngastrës/nënngastrës të përcaktuara për shfrytëzim, ku depozitohet e stivohet materiali drusor dhe nga ku transportohet jashtë ekonomisë pyjore..
- d) “Pikë tranziti”, vend depozitimi i përshtatshëm për stivimin e përkohshëm të materialit drusor.
- dh) “Mbritshmëri e pyjeve”, hyrja apo afrimi në një ekonomi pyjore dhe shpërndarja në brendësi të saj, në formë rrjeti, në zona apo pika të veçanta të tij, duke mundësuar vajtjen e njerëzve dhe teknikës së punës, për kryerjen e punimeve shfrytëzuese e silvoteknike, si: përkujdesjen, vjeljen e produkteve drusore, shëndetësimin.
- e) “Rrugë autopsyjore”, rrip toke i përgatitur për lëvizjen e mjeteve, njerëzve dhe kafshëve, ndërtuar mbi bazën e normave teknike për të lejuar qarkullimin e automjeteve në kushte të mira.
- ë) “Trase”, quhet vija apo linja që përcakton vendosjen në terren apo hartë të boshtit gjatësor gjeometrik të linjës transportuese.
- f) “Drurë industriale”, janë drurë dhe shkurre të cilat janë pjesë e Fondit Pyjor Kombëtar, në gjendje natyrore ose të kultivuara, me vlera të larta për përdorim në industrinë farmaceutike, përpunuese, etj., të tilla si: akacia, arra, blini, caraci, cërmëdeli, dafina, dëllinja, frashri, gështenja, murrizi, kulumbria, lajthia, mani, mështekna, panja, plepi, qershia e egër, shqema, shqopë, shtogu, ulli i egër, trëndafili i egër, valanidhi, verriu dhe vidhi.

- g) “Çekiç-damkë”, mjet në formë sëpate të vogël, me teh prerës në pjesën e përparme dhe i sheshtë në anën e pasme me një shenjë të gdhendur të përbërë nga një shkronjë dhe një numër që shërben për shënimin e drurëve që priten.
- gj) “BMET” janë bimë mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore sipas përcaktimit në nenin 4, të ligjit 10120, datë 23.4.2009, “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore dhe tanifere natyrore”, i ndryshuar.

KREU II

RREGULLAT E TRAJTIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË LËNDËS DRUSORE, PRODHIMEVE JODRUSORE PYJORE DHE BMET SI DHE KRITERET TEKNIKE PËR SHËNIMIN DHE ETIKETIMIN E PRODHIMEVE DRUSORE

Neni 3

Trajtimi dhe shfrytëzimi i materialit drusor

1. Trajtimi dhe shfrytëzimi i materialit drusor, përveç sa është përcaktuar në nenin 27, dhe 32 të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, bazohet edhe në rregullat e mëposhtme:
 - a) shfrytëzimi planifikohet çdo vit, në përputhje me urgjencën e prerjeve të lejuara, sipas ngastrave dhe nënngastrave pyjore, dhe të dhënave të planeve të mbarështimit apo të inventarizimit, të hartuara nga strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki.
 - b) Në pyjet me funksion mbrojtës e të veçantë, shfrytëzimi bëhet vetëm në rastet kur kryhen punimet e përkujdesjes dhe të prerjeve shëndetësore.
2. Shfrytëzimi i ngastrave/nënngastrave pyjore, përveç rasteve kur kryhet nga njësitë/ekipeve të specializuara të bashkisë, fillon vetëm pasi është lidhur kontrata e shfrytëzimit të materialit drusor midis bashkisë dhe subjektit të licencuar, si dhe pas pajisjes së subjektit me lejen e shfrytëzimit, sipas afateve të përcaktuara në këtë kontratë. Ngastrat/nënngastrat e miratuara për shfrytëzim, dorëzohen me procesverbal.
3. Në ngastrat dhe nënngastrat ku kryhen prerje të dyta e përfundimtare, shfrytëzimi bëhet në periudhën me dëborë. Kur prerjet e dyta e përfundimtare janë tepër të vonuara, shfrytëzimi lejohet gjatë gjithë periudhës së pushimit të vegetacionit.
4. Prerja e drurëve pyjorë fillon pasi bëhet shënimi i tyre me damkë të veçantë. Damkimi apo shënimi i drurëve që hiqen, kryhet në muajt maj-korrik, nga specialist i lartë pyjesh me përvojë pranë bashkisë dhe është përgjegjësi personale e tij për çdo parregullsi të konstatuar. Specialisti i lartë i pyjeve harton listdamkat dhe llogarit vëllimet, të cilat i nënshkruan së bashku me grupin e punës.
5. Në pyjet trungishte prerja lejohet gjatë gjithë vitit, kurse në pyjet cungishte dhe shkurret, të cilat ripërtërihen me lastarë, lejohet nga data 1 tetor deri në 31 mars të vitit pasardhës. Në rastet e vegetacionit të vonuar, struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki

zgjat periudhën e prerjes deri në 15 prill, për zonat fushore, dhe deri në 30 prill, për zonat malore.

6. Kërkesat teknike e metodike, si dhe rregullat e caktimit të ngastrave e të nënngastrave për shfrytëzim, të damkosjes së drurëve, të prerjes e asortimit të tyre, të transportit e stivosjes në anë të rrugës, janë të detajuara në Aneksin nr.1, që i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë e tij.
7. Sigurimi i druve të zjarrit për ngrohje, nga banorët e fshatrave në zonat malore dhe në brendësi të pyjeve, për nevojat e tyre, kryhet vetëm nëpërmjet mbledhjes/vlerësimit të materialit drusor nga drurët e rrëzuar apo të shkullur e thyer nga furtunat e zjarret dhe punimet silvikulturore të pyllit, me rrallime e prerje rigjeneruese e shëndetësuese, sipas projekteve të hartuara nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki dhe vlerësimit paraprak në vëllim të materialit drusor. Projektet e hartuara miratohen nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve, një vit përpara se të fillojë vjelja.
8. Me mbarimin e afatit sipas pikës 6 të këtij neni, përfundon shfrytëzimi i materialit drusor dhe prodhimeve jodrusore pyjore. Përrjashtim bën vetëm transporti i druve të zjarrit nga pikat e tranzitit, për ngrohje të komunitetit dhe enteve publike, i cili mund të shtyhet deri në 30 ditë kalendarike.
9. Prerja e drurëve industrial, lejohet vetëm në rastet kur ato janë të kalbur ose në tharje e sipër, janë të prekur nga sëmundje dhe dëmtues të cilët paraqesin rrezik tharjeje për vetë drurin ose burim infeksioni për drurët e tjerë, si dhe kur janë të dëmtuar rëndë e janë këputur shumë degë, maja të thyera dhe kurora është çarë më dysh.
10. Në çdo rast, prerja e materialit drusor, fillon vetëm pasi të jetë hartuar dhe/ose miratuar projekti teknologjik i ndërhyrjes sipas parashikimeve të ligjit nr. 57/2020, i ndryshuar, si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij. Modeli i projektit teknologjik është sipas Aneksit nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë e tij.
11. Përveç sa parashikohet në planet e mbarështimit, kryhen ndërhyrje urgjente me përparësi në rastet kur:
 - a) Grumbujt pyjorë janë tharë e djegur;
 - b) Grumbujt pyjorë janë të degraduar;
 - c) Grumbujt pyjorë janë prekur nga sëmundje e dëmtues.

Neni 4

Trajtimi dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve pyjore me filizëri të zhvilluar

Në sipërfaqet me filizëri të zhvilluar mbi lartësinë optimale lejohet vetëm ndërhyrja me krahë dhe transporti me kafshë pune. Treguesit optimalë janë:

- a) për pyjet e ahut, kur kanë filizërinë me moshë 6-10 vjet, lartësia e filizave 30-80 cm dhe mbi 3 filiza/m² ose ka mbi 30.000 filiza/ha të shpërndarë uniformisht, në mbi 80% të sipërfaqes;

- b) për pyjet e pishës së zezë, kur kanë filizërinë me moshë 4-6 vjet, lartësia e filizave 25-50 cm dhe mbi 2-3 filiza/m² ose ka mbi 20.000-30.000 filiza/ha të shpërndarë uniformisht, në mbi 80% të sipërfaqes.

Neni 5

Markimi dhe etiketimi i prodhimeve drusore

1. Prodhimet drusore që rezultojnë nga shfrytëzimi, shënohen me bojë të paheqshme sipas asortimenteve:
 - a) Drutë e zjarrit, me bojë me ngjyrë të zezë,
 - b) Lëndë ndërtimi, me bojë me ngjyrë të verdhë,
 - c) Lëndë punimi dhe trupa sharre mbi 22 cm, me bojë me ngjyrë të kuqe.
2. Prodhimet drusore që rezultojnë nga shfrytëzimi, etiketohen sipas asortimenteve dru zjarri dhe lëndë e sharruar. Etiketimi bëhet vetëm për rastet e lëvizjes së materialit drusor nga një bashki në tjetrën dhe për eksport në rastet kur lejohet. Etiketa ka formën e rombit me përmbajtje e madhësi:
 - a) Për drutë e zjarrit: Dru zjarri - 6*6 cm.
 - b) Lënda e sharruar: Lëndë e sharruar - 10*10 cm.

Neni 6

Dorëzimi i ngastrave/nënngastrave për trajtim dhe shfrytëzim të materialit drusor dhe kolaudimi i tyre

1. Dorëzimi i ngastrës/nënngastrës për trajtim dhe/ose shfrytëzim tek subjekti i kontraktuar mbështetet në projektin teknologjik të ndërhyrjes. Për çdo rast, nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki mbahet procesverbali i dorëzimit të çdo pjese dhe më pas atë të kolaudimit provizor të saj. E njëjta procedurë vijohet edhe me pjesët e tjera, deri në kolaudimin përfundimtar të ngastrës/nënngastrës.
2. Njësitë/ekipet e specializuara të bashkisë apo subjekti i kontraktuar për shfrytëzim mbajnë përgjegjësi për mos sigurimin e ripërtëritjes, dëmtimin e tokës pyjore, materialit të pa damkosur apo vlerësuar, dëmtimin e filizërisë, rënien e zjarreve, dëmtimin e shenjave të mbarështimit dhe të infrastrukturës pyjore.
3. Deri në momentin e kolaudimit përfundimtar të ngastrës/nënngastrës, mbrojtja nga dëmtimet dhe zjarret e ngastrave bëhet nga subjekti i kontraktuar për shfrytëzim, apo nga njësia/ekipi i specializuar i bashkisë kur shfrytëzohet prej saj.
4. Kolaudimet provizore dhe ai përfundimtar bëhen nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, në prani të drejtuesit teknik të njësisë/ekipit të specializuar të bashkisë apo subjektit të kontraktuar. Drejtuesi teknik i strukturës përkatëse përgjigjet për procesin e trajtimit dhe shfrytëzimit të lëndës drusore dhe produkteve jopyjore.

Neni 7

Trajtimi dhe shfrytëzimi i prodhimeve jodrusore pyjore dhe BMET

1. Ministria përgjegjëse për pyjet dhe kullotat miraton për çdo vit, mundësinë e vjeljes dhe grumbullimit të prodhimeve jodrusore pyjore dhe bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore (BMET), bazuar në potencialet, kriteret teknike dhe statusin e llojit, të parashikuar në aneksin nr. 3, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Kontigjenti i shfrytëzimit bazohet në studimin dhe projektin mbi mundësitë e grumbullimit të prodhimeve jodrusore pyjore dhe BMET, të hartuar nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki dhe miratuar nga ministria përgjegjëse për pyjet e kullotat.
3. Grumbullimi i prodhimeve jodrusore pyjore, që përfshijnë lulet, frutat, farat, sythat, bisqet, degët, drurët dekorativë, shpatullat, kalemata, gjethet, halat, boçet, zhukat, kallamishtet, rrëshirën, plisat, barin, rrënjët, zhardhokët, kërpudhat, myshqet, humusin, lëgushat, torfat, dheun, gurët, zhavorrin, rërën, bimët mjekësore, eterovajore e tanifere, dhe nënprodhimeve të tjera, pyjore e jopyjore, u lejohet personave, fizikë e juridikë, të pajisur me lejen përkatëse, të lëshuar nga struktura përgjegjëse për pyjet e kullotat pranë bashkisë,
4. Shfrytëzimi i prodhimeve të tjera jodrusore pyjore, fillon vetëm pasi të jetë lidhur kontrata dhe të jetë lëshuar leja e shfrytëzimit. Ngastrat/nënngastrat dorëzohen me procesverbal. Prodhimet jodrusore pyjore dhe BMET, mund të grumbullohen nga njësia/ekipi i specializuar i bashkisë, individët, banorët dhe subjekte fizike a private.

KREU III

SHITJA E MATERIALIT DRUSOR DHE PRODHIMEVE JODRUSORE PYJORE, TRANSPORT, EKSPORTI (NË RASTET E LEJUARA) DHE IMPORTI I TIJ

Neni 8

Shitja e materialit drusor dhe prodhimeve jodrusore pyjore

1. Shitja e materialit drusor për dru zjarri për nevoja të popullatës apo enteve publike, bëhet nga bashkitë, si dhe individë apo subjekte që zotërojnë të drejtën e shfrytëzimit.
2. Shitja e materialit drusor në këmbë apo me asortimente, bëhet me ankand të hapur. Në rastin kur shitja e materialit drusor bëhet në këmbë, atëherë çdo njësi mbarështimi, ngastër/nëngastër i nënshtrohet konkurrimit.
3. Në rast se nga shfrytëzimi i pyjeve publike të territorit të një bashkie ka tepriçë prodhimi të materialit drusor, pas plotësimit të nevojave të banorëve të saj dhe enteve të tjera publike, që veprojnë në të, bashkia këtë tepriçë ka të drejtë t'ua shesë bashkive të tjera të vendit, sipas kërkesës së këtyre të fundit.

4. Shitjes i nënshtrohet dhe materiali drusor i sekuestruar. Në këtë rast, procesverbali i sekuestrimit është pjesë e dokumentacionit të shitjes.
5. Shitja e materialit drusor të pyjeve private bëhet nga pronari te bashkia përkatëse sipas një marrëveshje paraprake dhe nevojave e kërkesave të saj. Në rastet kur bashkia nuk e blen këtë sasi materialit drusor, pronari ka të drejtë ta shesë vetë në treg.
6. Shitja e sasive të prodhimeve jodrusore pyjore dhe BMET, bëhet nga bashkitë nëse grumbullimi i tyre është realizuar nga njësitë/ekipet e specializuara të bashkisë, nga individët sipas sasive të miratuara nga strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki/zonat e mbrojtura dhe personat juridikë e fizikë sipas kontingjenteve të miratuara nga ministria përgjegjëse për pyjet e kullotat dhe kontratave me bashkitë përkatëse.

Neni 9

Transporti, eksporti (në rastet e lejuara) dhe importi i materialit drusor dhe prodhimeve jodrusore pyjore e BMET

1. Ndalohet eksporti i lëndës së rrumbullakët të papërpunuar dhe druve të zjarrit nga pyjet në pronësi publike.
2. Lejohet eksporti i produkteve drusore që rezultojnë të përpunuara në nënprodukte të tjera si element druri, paleta, brikete dhe pellet.
3. Lejohet eksporti i druve të zjarrit, si lëndë djegëse në kërcunj, kopaçe, në degë, në shkarpa, në ashkla, në copa të çara, të rrumbullakëta, si dhe të përpunuara në pellet, briket, që rezultojnë nga shfrytëzimi dhe trajtimi i ngastrave e grup ngastrave pyjore, kur subjektet gëzojnë të drejtën e trajtimit të materialit drusor referuar kontratave të vlefshme nga shfrytëzimi i pyjeve private.
4. Lejohet eksporti i tallashit të presuar të drurit (pellet), ku si lëndë e parë shërben vetëm tallashi i drurit dhe jo drutë e zjarrit edhe nga subjekte që kanë ngritur fabrika apo impiante përpunimi të tallashit, të cilët grumbullojnë tallash dhe mbetje në pikat e sharrimit dhe përpunimit të lëndës drusore në vend, sipas legjislacionit në fuqi.
5. Shitja, transporti, eksporti (kur lejohet) dhe importi i materialit drusor dhe të prodhimeve jodrusore pyjore e BMET, përveç rasteve kur kryhet nga njësitë/ekipet e specializuara të bashkisë, shoqërohet me dokumentacionin përkatës, ku përfshihen detyrimisht certifikata e origjinës, kontrata dhe leja e shfrytëzimit.
6. Subjekti për të miratimin për eksportin e produkteve drusore të përpunuara, duhet të provojë që sasia e kërkuar e lëndës drusore rezulton nga procedurat e rregullta ligjore në fuqi. Kërkesës për miratimin e eksportit, i nënshtrohet edhe materiali drusor që rezulton i importuar i cili pas përpunimit të tij, kërkohet të eksportohet.
7. Miratimi i sasive të kërkuara për eksport, shqyrtohet nga struktura përgjegjëse për pyjet në Ministri.

8. Kërkesa e subjektit për miratimin e eksportit të produkteve drusore të përpunuara, drejtohet tek struktura përgjegjëse për pyjet në bashki dhe shoqërohet me këto dokumente:
 - a) Kontrata e shfrytëzimit të lëndës drusore ndërmjet subjektit dhe strukturës përgjegjëse për pyjet ose pronarit privat, e konfirmuar nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki;
 - b) Evidenca e rakordimit me strukturën përgjegjëse për pyjet në bashki;
 - c) Kontrata e porosisë me subjektin pritës në vendin që eksportohet materiali.
 - ç) Certifikata e origjinës;
9. Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, përgatit dokumentacionin e duhur dhe e përcjell për trajtim në ministrinë përgjegjëse për pyjet. Struktura përgjegjëse për pyjet në Ministri, shqyrton kërkesën dhe nëse e gjen atë të rregullt përgatit shkresën për miratimin e eksportit të kërkuar.
10. Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki, çdo 3 (tre) muaj, bëjnë rakordimin me Degën e Doganës përkatëse në lidhje me sasi të prodhimeve drusore/produkteve jodrusore pyjore/BMET të eksportuara dhe importuara. Mbi bazën e këtyre të dhënave kryhen rakordimet me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

KREU IV

RRUGËT AUTOPYJORE, KATEGORIZIMI, PËRDORIMI DHE STANDARTET E TYRE

Neni 10

Kategorizimi dhe përdorimi i rrugëve autopyjore

1. Rrugët pyjore, janë të kategorive IV, V dhe VI, dhe ndahen në:
 - a) Rrugë auto kryesore, të hyrjes - Kategoria e IV,
 - b) Rrugë auto kryesore, të depërtimit - Kategoria e V,
 - c) Rrugë auto degëzuese - Kategoria e VI,
2. Rrugët sipas relievit ndahen në, rrugë fushore, kodrinore dhe malore.
3. Rrugët, sipas periudhës së shfrytëzimit ndahen në rrugë, të përhershme për periudha shfrytëzimi mbi 5 vjet, rrugë provizore deri në 5 vjet dhe rrugë sezonale.
4. Rrugët, sipas rripave (drejtimeve) të kalimit ndahen në, rrugë me një rrip kalimi dhe me dy rripa kalimi.
5. Rrugët autopyjore mbledhëse (variantet e vogla), projektohen për shpejtësi deri 10 km/orë, me gjerësi 3-3.5 m, kanë karakter sezonal dhe janë të pashtuara. Rrugët pyjore dytësore (sekondare) projektohen për shpejtësi 15 km/orë, me gjerësi 3,5-4 m dhe janë të shtuara me dy shtresa. Rrugët pyjore kryesore duhet të jenë me shtresë kalldrëmi/guri, të gjëra mbi 4 m dhe shpejtësi 25 km/orë.
6. Standardet janë sipas tabelës në Aneksin nr.4.

Neni 11

Rregulla të hollësishme për ndërtimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve autopyjore

1. Projektimi dhe ndërtimi i rrugëve autopyjore kryhet sipas rregullave apo normave teknike si vijon:
 - a) Gjerësia e platformës rrugore 4-4.5 m
 - b) Gjerësia e brezit të kalimit dhe bankinave 3-3.5 m dhe 0.5 m
 - c) Pjerrësia gjatësore maksimale, e drejtë 10-12 %
 - ç) Pjerrësia gjatësore, e kundërt 7-8 %
 - d) Rrezja minimale e kurbave 10 m
 - dh) Pjerrësia gjatësore në kurba dhe kordhele 4-8 % dhe 4-5 %
 - e) E drejta minimale e ndërmjetme, midis kurbave 12 m
 - ë) Pjerrësia tërthore e platformës/bankinave 2-3 % dhe 3-4 %
 - f) Pjerrësia tërthore në kurba 7-8 %
 - g) Pjerrësia e skarpateve në gjërmim dhe mbushje 1:1 dhe 1:1.5
 - gj) Sheshe ndërrimi të automjeteve çdo 0.5 km
2. Rrugët autopyjore ndërtohen të tilla që ato të përdoren si vijon:
 - a) rrugët, në përdorim gjithëvjeter të jenë 70-80 %, të mbritshme
 - b) rrugët në përdorim sezonal të jenë 20-30 % të mbritshme
3. Mirëmbajtja dhe riparimi i rrugëve pyjore bëhet sipas nevojave duke zbatuar normativat e pikës 1.

Kreu V Dispozita të fundit

1. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, vendimi nr. 438, datë 08.06.2016, i Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jo pyjore”, i ndryshuar si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Mjedisit nr. 2, datë 3.3.2017, “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore, për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim, sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje”, shfuqizohen.
2. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA